

UDHËZIM
Nr. 1, datë 24.3.2022

PËR NEVOJA TË MBROJTJES SË MJEDISIT, PARANDALIMIN E NDOTJES NË MJEDIS DHE PËRMIRËSIMIN E CILËSISË SË AJRIT, ÇAKTIMIN E DITËS PA MAKINA

Në mbështetje të nenit 104, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar; të nenit 7, të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1989, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; të ligjit nr. 162/2014, “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis”, të ndryshuar; dhe të ligjit nr. 155/2020, “Për ndryshimet klimatike”; si dhe bazuar në VKM-në nr. 112, datë 2.3.2022, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit”, brenda fushës së përgjegjësisë për mbrojtjen e mjedisit, Ministri i Turizmit dhe Mjedisit

UDHËZON:

1. Kryetarët e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, për nevoja të mbrojtjes së mjedisit, parandalimit të ndotjes në mjedis dhe përmirësimit të cilësisë së ajrit, të marrin masat e nevojshme për kufizimin e përkohshëm të qarkullimit, **të dielën e parë të çdo muaji**, të të gjitha kategorive të mjeteve private, në zonat e banuara, në njësitë përkatëse që ata administrojnë.

2. Për realizimin e iniciativës së ditës pa makina, njësitë e vetëqeverisjes vendore respektive, në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme, përcaktojnë masat, në përputhje me parashikimet e nenit 6 të Kodit Rrugor, por pa u kufizuar, në:

- a) kategorinë e zonës, në të cilat do të vendoset ndalimi i qarkullimit të mjeteve;
- b) kategorinë e mjeteve të parashikuara nga Kodi Rrugor, për të cilat duhet të ndalohet qarkullimi;
- c) orën nga e cila fillon dhe përfundon masa e përkohshme e ndalimit të qarkullimit.

3. Kryetarët e njësive të vetëqeverisjes vendore, në cilësinë e strukturës përgjegjëse lokale për zbatimin e masave për rregullimin e qarkullimit të mjeteve në qendrat e banuara, miratojnë urdhëresë të veçantë, të motivuara, për rregullimin e qarkullimit të dielën e parë të çdo muaj, si ditë pa makina në qendrat e banuara.

4. Kryetarët e njësive të qeverisjes vendore informojnë me të gjitha mjetet dhe format informuese për realizimin e kësaj nisme banorët e njësive administrative, brenda juridiksionit territorial të tyre.

5. Ngarkohen kryetarët e njësive të vetëqeverisjes për zbatim të këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT
Mirela Kumbaro Furxhi